

FJALA E DEPUTETIT XHELAL MZIU

E ENJTE 7 KORRIK 2022

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Në fakt, pritëm disa ditë afatin përfundimtar të Rrugës së Arbrit, por, pavarësisht se u dhamë edhe kohë, u detyruam të kërkojmë në interpelancë, kuptohet edhe për shkak të qytetarëve të qarkut të Dibrës, ministren në lidhje me këtë aks rrugor shumë të rëndësishëm jo vetëm për qarkun e Dibrës, por për të gjithë, pra një aks i rëndësishëm kombëtar. Në zgjedhjet e vitit 2013 nga Dibra Kryeministri i sotëm, shefi i opozitës së asaj kohe, tha se Rruga e Arbrit është lënë rrugëve dhe premtoi se ajo do të ishte puna e parë që do të bënte. Pra, krahas 300 mijë vendeve të punës, në fakt, asnjë vend pune nuk krijoi; krahas deklaratës së famshme për të pasur ujë vaditës në çdo parcelë, në fakt, asnjë gjë nuk ka bërë deri më sot; krahas ujit të pijshëm që do të kishte çdo familje, në fakt, qyteti ka vetëm 30 minuta ujë, deklaroi edhe përfundimin e Rrugës së Arbrit.

Që nga ajo ditë dhe deri më sot ka pasur 19 herë ose deklarata të Kryeministrit, ose të ministrave për fillimin e punimeve apo për mbarimin e punimeve dhe, në fakt, rruga ka ngelur rrugëve, ashtu siç thoshte Kryeministri i sotëm në atë periudhë. Në fakt, e kishte gabim atë thënie, sepse aq shumë rrugë u bënë në 8 vjet, saqë sot nuk kanë të krahasuar, pavarësisht se kanë kaluar 9 vjet nga ajo periudhë. Në periudhën 2005-2009 filloi Rruga e Arbrit, ku u ndërtuan më shumë se 20 kilometra rrugë me standarde bashkëkohore, si dhe kishin mbaruar 80% e punimeve në më shumë se 13 kilometra rrugë dhe kostoja e saj ishte vetëm 70 milionë euro. Me ardhjen e “Rilindjes” në pushtet jo vetëm që nuk filluan punimet në mandatin e parë, por iu deshën vite të fillonin, si dhe u bënë shpikje për këtë rrugë.

Do të bëheshin 1 miliard lekë investime nëpërmjet skemës së famshme të PPP-ve. Rruga e parë që do të bëhej do të ishte Rruga e Arbrit. Në fakt, ishte vërtet absurditet, ky ishte hapi i parë i

kësaj qeverie në shpikjen e PPP-ve të famshme, të cilat janë korruptive dhe nuk ka shqiptar që nuk e di. Kjo rrugë, edhe sot e kësaj dite ngelet rrugë e ngelur rrugëve ose një ëndërr për dibranët, për matjanët, për bulqizakët, sepse nuk ka mbaruar as gjysma e saj. Nuk po flasim për efektin financiar, që është vërtet i jashtëzakonshëm krahasuar me atë që është bërë, ose produkti që do të merret, nëse ajo rrugë do të mbarojë ndonjëherë. Në fakt, kur e shikon rrugën në 3D, të duket sikur është një rrugë vërtet bashkëkohore, por ato pak segmente rrugore që kanë mbaruar, të vjen keq t'i konsiderosh nacionale, që do të shkurtonin aksin e portit të Durrësit me Shkupin dhe, pse jo, edhe më gjerë se atë.

Në fakt, ajo rrugë nuk plotëson as kriteret e lidhjes me një qytet dhe jo më për të qenë rrugë ndërkombëtare. Segmenti i rrugës nga Bulqiza deri tek Ura e Çerenecit ka mbaruar dhe, pavarësisht se u bënë vite, është shumë herë më i mirë në standarde se kjo rrugë, që ka kushtuar disa herë më shumë se rruga aktuale. Pavarësisht lobimit për të gjetur momentin e fillimit të kësaj rruge, atë nuk e gjejmë dot. Megjithatë, në deklaratat e shumta që bënte Kryeministri, arritëm të gjejmë objektin e koncesionit, i cili ishte për 13 vjet, afati i punimeve ishte për 3 vjet, perioda e mirëmbajtjes së rrugës ishte për 10 vjet dhe kompania ishte e detyruar që brenda këtyre 3 vjetëve të bënte inaugurimin e rrugës. Një nga ato deklaratat e famshme të Kryeministrit të sotëm ishte: për ta ndërtuar rrugën me paratë e shtetit na duhen 13 vjet dhe, meqenëse nuk i kishim paratë për 13 vjet, atëherë do t'ia jepnim privatit, duke qenë se privati i kishte lekët.

Pra, financimi do të jepej për 13 vjet dhe rruga do të mbaronte për 3 vjet, madje ishte shkruar që nuk duhej të kalonte afati 3-vjeçar i ndërtimit të saj. Që nga ajo datë, sepse datat janë të shumta, edhe në vitin 2017, nuk e di cila datë duhet marrë si referencë e datës së fillimit të asaj rruge, di të them që ndërtimi i asaj rruge u lidh me një kontratë, që ishte jo pak, por 33,6 miliardë lekë pa TVSH, ose 404 miliardë lekë, ose 336 milionë euro, që do të paguheshin. Kjo ishte vërtet një kosto e jashtëzakonshme dhe një çmim rekord i këtij niveli rruge, që do të ndërtohej totalisht me një diferencë të theksuar me gjysmën e rrugës së mbaruar para vitit 2013. Rruga e Arbrit, pavarësisht se duhet të kishte mbaruar në vitin 2018, nëse i referohemi lidhjes së kontratës që ajo pati, në fakt, duhet të kishte mbaruar në vitin 2021.

Madje, edhe po të shohësh në faqen e Kryeministrisë, Kryeministri, në komunikim me “Gjoka konstruktion”, thotë që rruga do të mbarojë përpara afatit dhe i kërkon të mbarojë përpara afatit, sepse vetëm kjo është zgjidhja që mund t’i jepet kësaj rruge. Në fakt, ajo rrugë jo vetëm nuk mbaroi përpara afatit, por afati u shty dhe në çdo palë zgjedhje shkonin për t’i filluar apo për t’i përfunduar punimet në atë rrugë, por, në fakt, nuk ka mbaruar as 50% e saj.